

VENDIM
Nr.229, datë 25.4.2007

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE DHE TË
MATERIALEVE TË USHTRISË TURKE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të personelit, të përbërë me 60 (gjashtëdhjetë) trupa ushtarake, 8 (tetë) civilë dhe 41 (dyzet e një) mjete ushtarake turke, në itinerarin Hani i Hotit-Durrës, në datat 30 prill-5 maj 2007.

Nga këto, 6 (gjashtë) trupa ushtarake do të rikthehen në Bosnjë-Hercegovinë, në itinerarin Durrës-Hani i Hotit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit të kufirit, Hani i Hotit. Pika e daljes do të jetë pika e kalimit të kufirit, Durrës.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të personelit, të përbërë me 6 (gjashtë) trupa ushtarake, 1 civil dhe 9 (nëntë) mjete të ushtrisë turke, në itinerarin Morinë-Durrës, në datat 1-4 maj 2007.

Nga këto, 3 (tri) trupa ushtarake do të rikthehen në Kosovë, në itinerarin Durrës-Morinë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit të kufirit, Morinë. Pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit, Durrës.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Trupat dhe mjetet turke, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha